

njësitin e vet shpesh shkonte në Kosovë. Ka gjetur vdekjen gjatë luftimeve me pjesëtarët e UÇK-së në mëngjesin e datës **27.07.1998**, në **Mleqan/Mlečane**. E kanë varrosur në varrezat Leshqe në Beograd më 29.07.1998.

**Burimet:** deklarata S.Č, FDH-20829; deklarata A.P, FDH-30628; SV SR], *Junaci otadžbine*, 74; SMIP, *Teroristički...*, III, 936; Z. Stijović, *Kosmet...*, 110; M. Sekulić, *Beograd...*, 98; KMKRF], *Personat...*, FDH-10832.

## Jashar (Sherif) Krasniqi

(10.11.1947, shqiptar nga Tërpeza/Trpeza, komuna e Malishevës/Mališevo, mësues, katër fëmijë)

Jashari ka qenë mësues në shkollën fillore *Mustafa Bakija* në **Tërpezë/Trpeza**. Me bashkëshorten Sabrijen i kishin dy djem dhe dy vajza. Njëra prej tyre, Shqipja, ka qenë pjesëtare e UÇK-së. Në muajin korrik të vitit 1998, në afërsi të fshatit, në *Grykën e Llapushnikut/Lapušnička klisura*, zhvilloheshin luftimet mes forcave të UÇK-së dhe atyre serbe. Në datën **27.07.1998**, bashkëshortja e Jasharit dhe djemtë dhe vajzat u strehuan në Llashkadrenoc/Vlaški Drenovac. Ai mbeti vetëm në shtëpi. Disa ditë më vonë, vajza e Jasharit, Shqipja, ka mësuar nga ushtarët që e kryenin vëzhgimin e terrenit, se në fshatin Tërpezë/Trpeza e kishin vërejtur trupin e pajetë të një burri në oborrin e familjes Krasniqi. Pas nënshkrimit të marrëveshjes *Holbrooke - Milošević*, Shqipja me disa ushtarë të UÇK-së u kthyen në fshat më 17. 10. 1998. Në oborr, përpara derës hyrëse në shtëpi, e ka gjetur trupin e masakruar të të atit. E identifikoi në bazë të rrobave të trupit dhe gjësendeve personale. Të nesërmen, Shqipja, vëllezërit, farefisi dhe ushtarët e UÇK-së e kanë varrosur Jasharin në varrezat e Tërpezës/Trpeza. Nga viti 2000, shkolla në Tërpezë/Trpeza e mban emrin e Jasharit.

**Burimet:** deklarata S.K, FDH-16577; deklarata M.K, FDH-34652; deklarata B.H, FDH-2976; deklarata E.H, FDH-12199; KMDLNJ], *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 117, FDH-23857; *Returning Refugees Find Dead Relatives and Neighbours in War-Torn Villages*, pasqyra e lajmeve, KIC, 29.10.1998, FDH-29782.

## Hajdin (Demush) Kryeziu

(1.04.1939, shqiptar nga Bubavec/Bobovac, komuna e Malishevës/Mališevo, punëtor, tetë fëmijë)

Hajdini punonte në Gjermani, ndërsa familja i jetonte në Bubavec/Bobovac. Në vitin 1998, ai erdhi ta vizitonte familjen. Në të njëjtin vit filluan konfliktet në Kosovë dhe ai nuk kishte më mundësi të kthehej në Gjermani. Kur në orët e hershme të mëngjesit, më **28.07.1998**, forcat serbe filluan të depërtonin në fshat, bashkëshortja e tij Xhezidja me fëmijët u strehuan në pyllin e afërt, ndërkaq Hajdini mbeti në shtëpi [**Bubavec/Bobovac**]. Nuk e kanë parë të gjallë kurrë më. Më vonë, vendasi Daut Kryeziu i ka treguar djalit të Hajdinit, Mustafës, se ai atë ditë e kishte takuar Hajdinin në luginë përkaj vendit të quajtur *Mulliri i Bajrushit/Bajrušov mlin*, që nuk ishte larg shtëpisë së familjes Kryeziu. Hajdini i pati thënë Dautit se nuk ndjehej mirë dhe se donte të pushonte. Mustafa, i cili ishte ushtar i UÇK-së, ka mësuar nga bashkëluftëtarët, që i përgjonin bisedimet mes pjesëtarëve të forcave serbe, se pjesëtarët e UJ-së e kanë ndaluar një burrë të moshës së Hajdinit më 28.07.1998 dhe se e kanë çuar në shtabin e ushtrisë, në shkollën fillore. Fati i Hajdinit nuk është ndriçuar deri më sot. Në regjistrin e të zhdukurve që e administron KNKK-ja, rasti i Hajdinit është sistemuar në lëndë me numër BLG-801328-01.

**Burimet:** deklarata M.K, FDH-7154; deklarata M.K, FDH-17223; FHP, *Regjistri...*, FDH-859; FHP, *Që njerëzit i mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-31242; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

## Sherif (Sait) Hoti

(22.8.1938, shqiptar nga Caralluka/Crni Lug, komuna e Malishevës/Mališevo, bujk, dhjetë fëmijë)

Sherifi punonte si vozitës në kooperativën *Mirusha/Mirusha* në Carallukë/Crni Lug. Në fillim të muajit korrik të vitit 1998, kur filluan konfliktet të armatosura mes forcave serbe dhe atyre të UÇK-së përreth Carallukës/Crni Lug, Sherifi me familje kaluan në Lladroc/Ladrovac. I ati ka mbetur në shtëpi. Sherifi e